



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Letërsi e re Greke B1

Ngarkesa në orë/kredite: 40 orë mësimore, 4 kredite: 20 leksione, 20 seminare

Viti / Semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim në gjuhën greke dhe angleze”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs ka për qëllim përgatitjen e studentëve për një kuptim të thellë të letërsisë moderne greke, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësitë analitike dhe kritike për interpretimin e teksteve letrare. Studentët do të eksplorojnë zhvillimet historike dhe kulturore që kanë ndikuar në letërsinë greke, duke përfshirë periudhat e ndryshme letrare dhe ndikimet kryesore. Kursi synon gjithashtu të përgatisë studentët për të analizuar dhe interpretuar ndikimin e letërsisë në formimin e identitetit kombëtar dhe zhvillimin e gjuhës greke.

Objektivat specifike lëndore:

1. Studentët do të jenë të aftë të analizojnë dhe interpretojnë veprat kryesore të letërsisë moderne greke, duke përdorur mjete dhe metoda të kritikës letrare.

2. Të fitojnë aftësinë për të lidhur zhvillimet letrare me ngjarjet historike dhe ndryshimet shoqërore në Greqi gjatë periudhave të ndryshme.

Studentët do të zhvillojnë kompetenca në identifikimin e ndikimeve kulturore dhe gjuhësore në letërsinë greke.

3. Të jenë në gjendje të diskutojnë dhe debatojnë për ndikimin e letërsisë në formimin e identitetit kombëtar grek.

Rezultate të pritshme :

1. Analizojnë dhe interpretojnë tekstet kryesore të letërsisë moderne greke duke përdorur qasje të ndryshme kritike.

2. Lidhin zhvillimet historike dhe shoqërore me krijimet letrare të periudhave të ndryshme.

3. Identifikojnë dhe shpjegojnë ndikimet e letërsisë së huaj në formimin e letërsisë greke.

4. Diskutojnë rolin e letërsisë në formësimin e identitetit kombëtar dhe kulturor grek në kontekstin e historisë së shekujve të fundit.